



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 80, datë 30. 11. 2022

“PËR AKORDIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS SHKENCORE “VENDI DHE ROLI I SKRAPARIT NË LUFTËN ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30. 11. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, i ngritur me Urdherin Nr.86, datë 11. 03. 2022 në mbështetje të Ligjit Nr.9936, datë 26. 06. 2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 6;15;17;22;23;24;25;26;32, i ndryshuar me Ligjin Nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9936, datë 26. 06. 2008”, të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 6;7;39;40;41, Ligjit Nr. 115/2021, datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.09, date 20.03.2018, “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit

VENDOSI:

1. Akordimin e fondit prej 500 000 (pesëqind mijë) lekë për organizimin e konferencës shkencore “Vendi dhe roli i Skraparit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 8 vota pro , 1- votë kundër, 1- votë abstenim.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

